



E ARDHMJA E PROCESIT TË PAJTIMIT
PËRBRENDË KOSOVËS DHE NDËRMJET
KOSOVËS DHE **SERBISË**
NË KONTEKSTIN E 'FINALES SË MADHE'
EVENTUALE



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja. I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM:

E ARDHMJA E PROCESIT TË PAJTIMIT PËRBRENDIA
KOSOVËS DHE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË
NË KONTEKSTIN E ‘FINALES SË MADHE’
EVENTUALE

Tetor 2019

STUDIM:

E ARDHMJA E PROCESIT TË PAJTIMIT PËRBRENDË
KOSOVËS DHE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË
NË KONTEKSTIN E ‘FINALES SË MADHE’
EVENTUALE

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Tetor 2019

Përmbajtja

Shkurtesat.....	i
Hyrje.....	1
Historiku i konfliktit	2
Mekanizmat institucional dhe kuadri ligjor brenda Kosovës në adresimin e krimeve të luftës	3
Ballafaqimi me krimet e luftës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	7
Ministria për Komunitete dhe Kthim në procesin e pajtimit	11
Procesi i pajtimit përmes iniciativave të shoqërisë civile.....	14
Ekipi Përgatitor i Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë	16
Institucionet ligjore dhe mekanizmat e Serbisë që merren me krimet e luftës në Kosovë	19
Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe Pajtimi.....	24
Përfundime	27
Rekomandime.....	28

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
DHS	Dhomat e Specializuara
DKL	Departamenti i Krimeve të Luftës
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FDH	Fondi për të Drejtën Humanitare
GJPNJ	Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë
KOMRA	Komisioni Rajonal për Fakte rreth të gjitha Viktimave të Krimeve të Luftërave dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë
KPV	Komisioni i Pajtimit dhe të Vërtetës
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
NJHKL	Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKDNJ	Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
PKL	Prokuroria e Krimeve të Luftës
QHDP	Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
QNDT	Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale
SHHKL	Shërbimi për Hetimin e Krimeve të Luftës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UJ	Ushtria Jugosllave
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZPS	Zyra e Prokurorit Special
ZPZHML	Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore

Hyrje

1. Kosova dhe Serbia shënojnë pothuajse dy dekada që nga përfundimi i konfliktit në mes dy vendeve. Arritja e pajtimit ndërmjet komuniteteve në Kosovë dhe ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në veçanti, mbetet një nga detyrat më të vështira për t'u përmbushur. Konflikti në vitet 1998-99 rezultoi me viktima të shumta, persona të zhdukur dhe popullsi të zhvendosur. Këto aspekte mbeten në thelb të ankesave të vazhdueshme dhe tensioneve në Kosovë. Për më tepër, situata e pas konfliktit karakterizohet me narrativa të ndryshme konflikti që shërbejnë për të ruajtur status quo-në ndërmjet komuniteteve. Rrjedhimisht, nuk ka ndarje të qartë në mes viktimës dhe dhunuesit dhe kjo çon në armiqësi të mëtejshme brenda komuniteteve në Kosovë. Të dy komunitetet kanë krijuar narrativa të viktimave përderisa vazhdojnë ta fajësojnë njeri-tjetrin për shkelje – prandaj, për këtë arsye ka nevojë për ta trajtuar këtë çështje më në thellësi brenda Kosovës dhe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.
2. Ky studim trajton aspektet e procesit të pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Analizon rolin e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë dhe kontributin e tyre për procesin e pajtimit. Studimi ofron një rast krahasues që mund të jetë i dobishëm për drejtësinë tranzicionale në Kosovë për të ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Më tej, roli i aktorëve politikë, veçanërisht në kuadrin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është diskutuar, si dhe mënyrat e mundshme për ta inkorporuar pajtimin si pjesë të dialogut të lehtësuar nga BE-ja.
3. Duke pasur parasysh këtë, gjithmonë ka nevojë për nismat e pajtimit që do të ndërtojnë besimin dhe respektin e ndërsjellë ndërmjet komuniteteve. Megjithatë, procesi i pajtimit është shumë fluid dhe kërkon masa sistematike që ndoshta do të tkurrin divergjencat.

Historiku i konfliktit

4. Në shqyrtimin e konfliktit në ish-Jugosllavi, vlerësohet se më shumë se 6,000 persona janë evidentuar si të zhdukur gjatë konfliktit në Kosovë 1998-99 dhe pas tij. Procesi i numërimit të personave të zhdukur ka dhënë rezultate, duke mundësuar identifikimin e më shumë se 4,000 sosh. Njëzet vjet pas konfliktit, 1,647 persona mbetën të zhdukur, shumica prej tyre shqiptarë, por gjithashtu duke përfshirë serbët dhe komunitetet e tjera në Kosovë. Deri në fund të konfliktit është vlerësuar se rreth 12.000 shqiptarë të Kosovës ishin vrarë.¹ Rreth 800 serbë, romë dhe pjestarë të komuniteteve të tjera minoritare u zhdukën gjatë konfliktit të Kosovës në vitin 1999 dhe pas tij. Vlerësimet tregojnë se rreth 800,000 shqiptarë të Kosovës janë zhvendosur gjatë vitit 1999. Nga ana tjetër, popullsia e zhvendosur serbe brenda rajonit dhe në Kosovë varion nga 80,000 deri 110,000.
5. Pavarësisht nga natyra e gjerë dhe sistematike e dhunës në Kosovë, një numër i vogël njerëzish përgjegjës për kryerjen e krimeve janë ndjekur penalisht. Mungesa e vullnetit politik për të mbështetur sanksionimin e krimeve të luftës dhe sistemi i dobët gjyqësor për të ndjekur penalisht këto krime e bën të pasigurtë që autorët e veprave do të mbahen përgjegjës për krimet e kryera në Kosovë.²
6. Gjykimet për krimet e luftës në Kosovë janë mbajtur në disa gjykata të veçanta me juridiksion mbi Kosovën: Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (GJPNJ); në Dhomën e Posaçme për Krimet e Luftës në Beograd në Serbi; dhe Gjykatat e UNMIK-ut nga viti 1999 deri më 2008, duke vazhduar me misionin e

¹ Amnesty International (2017), 'Plagët që na djegin shpirtrat tanë.' Në dispozicion në: <https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR7075582017ENGLISH.PDF> [Qasur më: 10 tetor 2019].

² Amnesty International (2017), 'Plagët që na djegin shpirtrat tanë.' Në dispozicion në: <https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR7075582017ENGLISH.PDF> [Qasur më: 10 tetor 2019].

EULEX-it për trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë pas vitit 2008 dhe gjykatave të Kosovës pas përfundimit të misionit të EULEX-it.³

7. Në vitin 2009, Gjykata Penale Ndërkombëtare për Jugosllavi, dënoi disa nga zyrtarët më të lartë politikë, policorë dhe ushtarakë serbë për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit në Kosovë, duke përfshirë 'sulmet seksuale si formë persekutimi dhe si krim kundër njerëzimit; një zyrtar i lartë u dënua në vitin 2014 për përndjekje përmes sulmeve seksuale, si një krim kundër njerëzimit'.⁴ Gjithashtu, komandantët e nivelit të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë gjykuar në GJPNJ.
8. Sipas ligjit ndërkombëtar, rregulli/ligji 117 për personat e zhdukur, secila palë e përfshirë në konflikt është përgjegjëse për garantimin e të drejtave bazike të viktimave dhe gjithashtu duhet të lajmëroj anëtarët e familjeve të personave të raportuar si të zhdukur për informacionet mbi fatin e këtyre të fundit.⁵ Ky obligim përfshinë qasje të barabartë dhe efektive në drejtësi dhe të drejtën për dëmshpërblim adekuat, efektiv dhe të menjëhershëm për dëmin e pësuar, duke përfshirë kthimin, kompensimin, rehabilitimin, kënaqshmërinë dhe garancitë e mospërsëritjes. Në përgjithësi, këto masa kanë për qëllim të adresojnë vuajtjet e viktimave dhe t'i ndihmojnë ata të rindërtojnë jetën e tyre.⁶

Mekanizmat institucional dhe kuadri ligjor brenda Kosovës në adresimin e krimeve të luftës

9. Institucionet ndërkombëtare kanë trajtuar drejtësinë penale në Kosovë. Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë u themelua nga Këshilli i Sigurimit i

³OSBE Misioni në Serbi (2015), 'Procedimet e krimeve të luftës në Serbi (2003-2014)' Në dispozicion në: <https://www.osce.org/serbia/194461?download=true> [Qasur më: 12 tetor 2019].

⁴ Amnesty International (2017), 'Plagët që na djegin shpirtrat tanë.' Në dispozicion në: <https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR7075582017ENGLISH.PDF> [Qasur më: 10 tetor 2019].

⁵ Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (2019), 'Rregulli 117. Llogaridhënia për personat e pagjetur', Në dispozicion në: https://ihl-databases.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1_rul_rule117 [Qasur më: 12 tetor 2019].

⁶ Amnesty International (2017), 'Plagët që na djegin shpirtrat tanë.' Në dispozicion në: <https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR7075582017ENGLISH.PDF> [Qasur më: 10 tetor 2019].

OKB-së gjatë konflikteve në Ballkan në vitet 1990-ta dhe mandati i saj zgjati nga viti 1993 deri në vitin 2017. Gjykata gjatë mandatit të saj ka një rekord prej 161 individësh të akuzuar nga të cilët 90 janë dënuar.⁷ Ish-udhëheqësi jugosllav, Slobodan Millosheviç, ishte presidenti i parë që u akuzua për krimet e luftës kur Tribunali e paditi atë për krimet e supozuara të kryera në Kosovë në vitin 1999. Ai qëndroi në gjyq prej vitit 2002 deri në vitin 2006 për krimet e dyshuara të kryera në Kosovë, Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë. Megjithatë, ai vdiq për shkak të shkaqeve natyrore para se një verdikt i gjykatës të ipej.⁸ Për krimet kundër njerëzimit të kryera në Kosovë pesë zyrtarë të lartë politik, ushtarak dhe policor serb dhe jugosllavë u shpallën fajtor. Zëvendëskryeministri i mëparshëm jugosllav, Nikola Shainoviç, gjeneral i Ushtrisë Jugosllave (UJ), Nebojsa Pavkoviç, gjenerali i policisë serbe Sreten Lukic, gjenerali i ushtrisë jugosllave, Vladimir Lazareviç dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Dragojlob Ojdaniq u shpallën fajtorë.⁹ Megjithatë, gjykimi i parë për krimet e luftës të kryera gjatë konfliktit në Kosovë është bërë në nëntor të vitit 2005, kundër anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Fatmir Limajt, Isak Musliut dhe Haradin Balës. Ata janë akuzuar për krime të supozuara të kryera në vitin 1998 në kampin e paraburgimit në Llapushnik në Kosovë.¹⁰ Fatmir Limaj dhe Isak Musliu u gjetën të pafajshëm, ndërsa Haradin Bala u dënua me 13 vjet burg. Në të njëjtin vit, tre pjesëtarë të tjerë të UÇK-së u paditën. Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lah Ibrahimaj u akuzuan për disa vepra të dyshuara, ndërsa gjyqi për Haradinaj dhe të tjerët, së pari përfundoi në vitin 2008 ku Hardinaj dhe Balaj u gjetën të pafajshëm. Një rigjykim i pjesshëm do të zhvillohej në vitin 2010, para se të tre ata të liroheshin në vitin 2012.¹¹

⁷ Gjykata Penale Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për ish-Jugosllavinë (2019), 'GJPNJ 1993-2017'. Në dispozicion në: <https://www.icty.org/> [Qasur më: 13 tetor 2019].

⁸ Gjykata Penale Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për ish-Jugosllavinë (2019), 'Çështja e ndjekjes-Kosova' Në dispozicion në <http://www.icty.org/en/content/prosecution-case-kosovo> [Qasur më: 11 tetor 2019].

⁹ Po aty.

¹⁰ KOSOVO 2.0. (2017), 'Fundi i GJPNJ-së'. Në dispozicion në : <https://kosovotwopointzero.com/en/the-end-of-the-icty/> [Qasur më: 13 tetor 2019].

¹¹ Po aty.

10. Pas konfliktit në Kosovë, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë sipas rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit ishte zyrtarisht i mandatuar me objektivën për të siguruar një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës. Misioni i UNMIK-ut u organizua rreth katër shtyllave kryesore, dhe Policia dhe Drejtësia ishte një ndër shtyllat kryesore. Brenda shtyllës së drejtësisë, UNMIK kishte gjithashtu përgjegjësinë për tu marrë me krimet e luftës. UNMIK ishte autoriteti i vetëm mbi krimet e luftës në Kosovë, dhe një nga mekanizmat e UNMIK-ut për të hetuar krimet e luftës ishte Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës (NJHKL). Për më tepër, UNMIK-u themeloi Zyrën për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (ZPZHML), e cila ishte po ashtu autoriteti i vetëm i mandatuar për të përcaktuar vendndodhjen e personave të zhdukur, për të identifikuar mbetjet mortore dhe për t'i kthyer trupat tek familjet e tyre.¹² UNMIK në kuadër të Sistemit të Drejtësisë Emergjente emëroi gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë në gjithë territorin e Kosovës, në atë mënyrë që akuzat për krime lufte të mos jenë të njëanshme etnikisht.¹³ Përveç kësaj, sipas raportit të OSBE-së për krimet e luftës, nuk ekziston një bazë e të dhënave të besueshme për rastet e krimeve të luftës nga periudha e UNMIK-ut për shkak të autoriteteve të ndryshme të angazhuara në këtë proces, dhe nuk ka një bazë të dhënash të centralizuar për këto raste.¹⁴ Një iniciativë e rëndësishme në vitin 1999 ishte themelimi i Gjykatës së Kosovës për Luftë dhe Krime Etnike (KWECC), një tribunal special që do të trajtonte krimet e luftës dhe krimet e tjera të motivuara etnikisht, por për shkak të kufizimeve buxhetore dhe zhvillimit të gjykatave lokale, iniciativa u braktis. Misioni i UNMIK-ut përfshirë fushën e drejtësisë dhe policisë përfundoi në dhjetor të vitit 2008 me EULEX-in që morri kontroll të plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit.¹⁵ Çfarë mund të vërehet në atë periudhë është se qytetarët kanë shfaqur pakënaqësi me UNMIK-un në trajtimin e trashëgimisë së konfliktit. Ankesat përfshinin dështimin e misionit

¹² Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. (2015). 'Opinion' Në dispozicion në: <http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Cases%20Eng/132-09%20Opinion%20Signed.pdf> [Qasur më: 13 tetor 2019].

¹³ OSBE (2010). 'Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë: Një Vlerësim Dhjetë Vjeçar (1999-2009)' Në dispozicion në: <https://www.osce.org/kosovo/68569?download=true> [Qasur më: 13 tetor 2019].

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

për të korrigjuar dëmin që kishte ardhur si pasojë e konfliktit të dhunshëm.¹⁶ Shqetësimi kryesor i popullsisë ishte qasja joadekuade e UNMIK-ut, për çështjen e personave të zhdukur dhe mungesën e hetimeve të duhura për krimet e luftës, por gjithashtu duke përfshirë edhe çështjet pronësore si rezultat i zhvendosjeve.¹⁷

11. Që prej vitit 1999 aktorët ndërkombëtarë, së pari UNMIK dhe më pas EULEX prej 2008 deri me 2020 (me mandatin e ri të kufizuar) kanë pasur rolin udhëheqës në rivendosjen e drejtësisë për krimet e luftës në Kosovë. Ndikimi kryesor i këtyre misionëve ndërkombëtare në Kosovë ishte menaxhimi i konfliktit; pavarësisht disa iniciativave për të mbështetur paqen afatgjatë, e cila do të mund të çonte në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve. Aktorët ndërkombëtarë dhe lokalë kanë bërë përpjekje të ndryshme për të nxitur procesin e drejtësisë tranzicionale, megjithatë pengesat politike e vështirësuan procesin.¹⁸

12. Që prej përfundimit të konfliktit konsiderohet gjerësisht se aktorët ndërkombëtarë kanë dështuar në adresimin e krimeve të luftës. Megjithëqë krimet e luftës kishin vëmendjen e publikut dhe të aktorëve relevantë - e njëjta gjë nuk u reflektua në punën në terren kur bëhet fjalë për aktakuzat e këtyre krimeve.¹⁹

13. Prandaj, dështimi për të trajtuar krimet e luftës ka penguar procesin e normalizimit të marrëdhënieve, pasi të dyja entitetet, shqiptarët dhe serbët mbeten të ngulitur në pozicione antagoniste. Përveç krimeve të luftës, ka shumë shkelje të tjera të të drejtave të njeriut që duhet të merren parasysh. Mijëra njerëz u ndoqën padrejtësisht nga sistemi gjyqësor serb (atëherë ish-Jugosllavia). Çështjet, të tilla si shkatërrimi i pronës, zhvendosja me forcë, zhvatja e parave, ndalimet dhe kështu me radhë përbëjnë disa nga shkeljet që nuk kanë marrë vëmendje dhe përgjegjësi

¹⁶Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. (2016), 'Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut: Historia dhe Trashëgimia e Kosovës, 2007-2016' Në dispozicion në: <http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/default.aspx> [Qasur më: 13 tetor 2019].

¹⁷Po aty.

¹⁸Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (2018), 'Zbërthimi i pajtimit në Kosovë' fq.3, Në dispozicion në: <http://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2018/03/CRDP-Policy-Brief-on-Deconstructing-Reconciliation-EN.pdf> [Qasur më: 14 tetor 2019].

¹⁹OSBE (2010), 'Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë: Një Vlerësim Dhjetë Vjeçar (1999-2009)' Në dispozicion në: <https://www.osce.org/kosovo/68569?download=true> [Qasur më: 13 tetor 2019].

të duhur.²⁰ Si pasojë, ka një pakënaqësi të përgjithshme mes njerëzve për mungesën e hapave konkretë në identifikimin dhe ndjekjen penale të individëve që kanë kryer krime lufte dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Rrjedhimisht, ka pasur një rritje të mosbesimit ndaj institucioneve që kanë të bëjnë me trashëgiminë e konfliktit, gjë që ka reflektuar edhe në armiqtësi më të thella dhe pabarazi në lidhje me normalizimin e marrëdhënieve.

14. Faza fillestare e normalizimit të marrëdhënieve ka kaluar përmes drejtësisë penale e cila në rastin e Kosovës është zbatuar në dy nivele; ndërkombëtare dhe lokale. Masat legislative formuan bazën për trajtimin e drejtësisë dhe pajtimit. Strategjitë institucionale për siguri, ndërtimin e paqes dhe pajtimin në Kosovë u zbatuan përmes institucioneve të tilla si OKB, NATO dhe BE.²¹

Ballafaqimi me krimet e luftës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës

15. Parlamenti i Kosovës shpalli pavarësinë e vendit me 17 shkurt 2008. Deklarata e pavarësisë shënoi fundin e periudhës së UNMIK-ut dhe tranzicionit gradual të kompetencave të UNMIK-ut tek qeveria e sapokrijuar e Kosovës. Megjithatë, procesi i trajtimit të krimeve të luftës u transferua në misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). EULEX “ka trashëguar 1200 raste të krimeve të luftës nga UNMIK, por ka mbyllur ose hedhur poshtë 500 prej tyre për shkak të mungesës së provave”.²²

16. EULEX zyrtarisht filloi veprimtarinë e tij në dhjetor 2008. Misioni i tij ishte të “monitorojë, mentorojë dhe këshilloj që të ruaj kompetenca të limituara ekzekutive

²⁰ OSBE Misioni Verifikues (2003). ‘Kosova/Kosovo ashtu siç shihet siç thuhet’ Në dispozicion në: <https://www.osce.org/odihr/17772?download=true> [Qasur më: 13 tetor 2019].

²¹ Qendra për Hulumtim Dokumentim dhe Publikim (2017), ‘Zbërthimi i pajtimit në Kosovë’, Në dispozicion në: <https://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2017/06/Zb%C3%ABrthimi-i-konceptit-t%C3%AB-pajtimit-n%C3%AB-kontekstin-e-Kosov%C3%ABs-Deconstructing-Reconciliation-Qershor-2017.pdf> [Qasur më: 13 tetor 2019].

²² EULEX (2019), ‘EULEX dhe Krimet e Luftës’ Në dispozicion në: <https://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000427.php> [Qasur më: 14 tetor 2019].

në fushën e sundimit të ligjit”.²³ Misioni i përgjithshëm i EULEX-it është të ndihmojë autoritetet e Kosovës në krijimin e institucioneve të qëndrueshme dhe të besueshme të sundimit të ligjit. EULEX funksionon sipas kuadrit të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.²⁴ EULEX që prej vitit 2014 ka shkurtuar numrin e personelit si dhe të rasteve që i trajton. Misioni i tij që zbatohet përmes shtyllave të monitorimit dhe operimit do ta mbulojë periudhën kohore deri me 14 qershor 2020.²⁵ Krimet e luftës janë një nga fushat që EULEX ka qenë përgjegjës që prej vitit 2008.

17. Kur bëhet fjalë për krimet e luftës, EULEX-i ka një regjistër prej 600 rastesh në pritje, që janë në përgjegjësi të prokurorëve të Kosovës dhe të EULEX-it; megjithatë, EULEX ka nisur 51 raste të reja të krimeve të luftës, përfshirë rastet e dhunës seksuale dhe dhunimin që shënohen për herë të parë. Në anën tjetër, EULEX-i ka gjykuar 15 raste të krimeve të luftës, gjysma e të cilave përfshin të pandehurit serbë dhe vetëm pak më shumë se gjysma e këtyre (8) të akuzuarve shqiptarë.²⁶ Ka ende raste aktive të personave të zhdukur, dhe janë rreth 100 raste të krimeve të luftës që janë aktualisht nën hetim nga EULEX në bashkëpunim me institucionet e Kosovës.²⁷ Një numër i rasteve të krimeve të luftës pritet të transferohen tek gjykatat e Kosovës. Sipas Strategjisë së re për Krimet e Luftës, një department që do të merret me krimet e luftës do të themelohet, dhe do të trajtojë krimet e dyshuara të luftës duke përfshirë të gjitha etnitë që jetojnë në Kosovë.²⁸

18. Se sistemi legjislativ i Kosovës dhe në një masë edhe institucionet ndërkombëtare nuk kanë arritur t'i trajtojë krimet e luftës në mënyrë të duhur - pranohet

²³ OSBE (2010). 'Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë: Një Vlerësim Dhjetë Vjeçar (1999-2009)' fq.14, Në dispozicion në: <https://www.osce.org/kosovo/68569?download=true> [Qasur më 13 tetor 2019].

²⁴EULEX (2019), 'Çka është EULEX-i?' Në dispozicion në: <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,16>[Qasur më: 14 tetor 2019].

²⁵Po aty.

²⁶ EULEX (2019), 'EULEX dhe Krimet e Luftës' Në dispozicion në: <https://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000427.php>[Qasur më: 14 tetor 2019].

²⁷Po aty.

²⁸ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (2019). 'Strategjia e krimeve të luftës dokumenti i parë i këtij lloji në Kosovë' Në dispozicion në: <http://www.gjyqesori-rks.org/2019/05/10/strategjia-e-krimeve-te-luftes-dokument-i-pare-i-ketij-lloji-ne-kosove/> [Qasur më: 12 tetor 2019].

gjerësisht. Prandaj, Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe zyra e Prokurorit Special tashmë janë themeluar në Hagë, Holandë. Ky institucion vepron në Hagë në përputhje me ligjet e Kosovës, për të kërkuar drejtësi për krimet e luftës dhe krimet e pasluftës.²⁹ Ky organ ligjor është themeluar për shkak të raportit të senatorit zvicran Dik Marti në vitin 2010. Ky raport i paraqitur në Asamblenë e Këshillit të Evropës tregoi se disa serbë dhe shqiptarë të Kosovës u mbajtën në burgje në Shqipërinë e veriut dhe iu nënshtruan trajtimit çnjerëzor. Raporti më tej sugjeron që nën kontrollin e UÇK-së në një territor pranë Fushë-Krujës u hoqën organet nga disa të burgosur për t'u transferuar jashtë vendit për transplantim.³⁰

19. Dhomat e Specializuara (DHS) dhe zyra e Prokurorit Special (ZPC) 'kanë mandat dhe juridiksion mbi krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimet e tjera të ngjashme nën ligjet e Kosovës.' DHS dhe ZPC janë institucione të përkohshme gjyqësore dhe hetojnë "krimet e supozuara të kryera ndërmjet 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetor 2000.³¹ Bashkësia ndërkombëtare pret që institucionet e Kosovës të marrin përgjegjësinë për krimet e luftës dhe keqbërjet e tjera nga konflikti i kaluar.³²

20. Procesi i pajtimit kishte shumë pengesa me kornizën legislative që ndryshonte shpesh për shkak të misionëve të ndryshme të huaja në Kosovë. Mungesa e vullnetit politik dhe tensioneve etnike brenda shoqërisë kosovare dhe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe humbja e besimit në institucionet ndërkombëtare e komplikuan më tej pajtimin. Prandaj, pajtimi mbetet një sfidë që kërkon

²⁹Qendra për Huluntim Dokumentim dhe Publikim (2017), 'Zbërthimi i pajtimit në Kosovë' Në dispozicion në: <https://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2017/06/Zb%C3%ABrthimi-i-konceptit-t%C3%AB-pajtimit-n%C3%AB-kontekstin-e-Kosov%C3%ABs-Deconstructing-Reconciliation-Qershor-2017.pdf> [Qasur më: 13 tetor 2019].

³⁰Këshilli i Evropës – Asambleja Parlamentare (2011), 'Raport: Trajtimi çnjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë' Në dispozicion në: <http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-EN.asp?fileid=12608&wrid=0&ref=3446&lang=EN> [Qasur më: 14 tetor 2019].

³¹Dhomat e Specializuara të Kosovës & Zyra e Prokurorit Special (2019). Në dispozicion në: <https://www.scp-ks.org/en> [Qasur më: 11 tetor 2019].

³²Visoka, G. (2017), 'Vlerësimi i Ndikimit Potencial të Gjykatës Speciale të Kosovës'. Në dispozicion në: <https://www.impunitywatch.org/publications/vleresimi-i-ndikimit-potencial-te-gjykates-speciale-te-kosoves> [Qasur më: 14 tetor 2019].

angazhimin e shumë aktorëve socialë, gjithashtu duke krijuar një atmosferë shoqërore që është në favor të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

21. Në vitin 2012, qeveria e Kosovës krijoi një grup ndërministror për t'u marrë me krimet e luftës dhe për të vendosur pajtimin. Mandati i këtij grupi ndërministror bazohej në katër shtyllat e drejtësisë tranzicionale: "gjetja e së vërtetës, dëmshpërblimet për viktimat, e drejta për drejtësi dhe reforma institucionale".³³

22. Përkundër angazhimit të sinqertë të anëtarëve të grupit punues, ky grup nuk arriti të përmbushë objektivat e tij për shkak të një numri faktorësh, duke përfshirë menaxhimin joadekuat dhe mungesën e pronësisë politike, përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e dobët të komuniteteve pakicë në Kosovë, mos përfaqësimin e viktimave civile të luftës dhe mos përfshirjen e publikut të gjerë.³⁴ Megjithëse konsiderohej si një projekt që mund të mblidhte aktorë të ndryshëm për të krijuar një strategji për t'u marrë me të kaluarën, mungonte mbështetja financiare dhe politike, rrjedhimisht kjo strategji nuk është zhvilluar deri tani. Për më tepër, Kosova mbeti pa një kornizë të përshtatshme për t'u marrë me të kaluarën dhe në bazë të të cilave politikat mund të zbatohen.³⁵

23. Deri tani, këto iniciativa të drejtësisë tranzicionale në Kosovë nuk kanë arritur të adresojnë krimet e luftës. Gjyqet ndërkombëtare dhe hibride për krimet e luftës janë parë nga komunitetet shqiptare dhe serbe në Kosovë si mekanizma për të kërkuar llogaridhënie nga pala tjetër për keqbërjet e kryera, dhe për të zgjeruar

³³ Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (2017), 'Zbërthimi i pajtimit në Kosovë' fq.17 , Në dispozicion në: <https://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2017/06/Zb%C3%ABrthimi-i-konceptit-t%C3%AB-pajtimit-n%C3%AB-kontekstin-e-Kosov%C3%ABs-Deconstructing-Reconciliation-Qershor-2017.pdf> [Qasur më: 13 tetor 2019].

³⁴ KOSOVO 2.0 (2017), 'Si mund të merret Kosova me të kaluarën e kohës së luftës? 'Në dispozicion në: <https://kosovotwopointzero.com/en/can-kosovo-deal-wartime-past/> [Qasur më: 14 tetor 2019].

³⁵ Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (2017), 'Zbërthimi i pajtimit në Kosovë' fq.18 , Në dispozicion në: <https://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2017/06/Zb%C3%ABrthimi-i-konceptit-t%C3%AB-pajtimit-n%C3%AB-kontekstin-e-Kosov%C3%ABs-Deconstructing-Reconciliation-Qershor-2017.pdf> [Qasur më: 14 tetor 2019].

fuqinë politike të linjave të ashpra nacionaliste. Gjykatat ndërkombëtare në Kosovë u përqëndruan kryesisht në drejtësinë penale dhe injoruan aspekte të tjera të drejtësisë tranzicionale, si kërkimi i së vërtetës, mbështetja e viktimave, ngacmimi, dëmshpërblimet dhe pajtimi i komunitetit.³⁶

Ministria për Komunitete dhe Kthim në procesin e pajtimit

24. Me qëllim të sigurimit të kthimit të sigurt për personat e zhvendosur, Kosova në janar 2005 ka themeluar Ministrinë për Komunitete dhe Kthim sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/50.³⁷ Para kësaj, një zyrë për komunitete dhe kthim ekzistonte brenda zyrës së Kryeministrit. Ministria për Komunitete dhe Kthim është përgjegjëse për promovimin dhe mbrojtjen e komuniteteve dhe të drejtat e tyre, përfshirë të drejtën për t'u kthyer dhe integruar. Për më tepër, ajo zbaton legjislacionin adekuat për të drejtat e komuniteteve; "duke udhëhequr në aktivitetet e ndërtimit të besimit, dialogut dhe pajtimit mes komuniteteve, si dhe mbështetjes së zbatimit të këtyre aktiviteteve".³⁸

25. Shkatërrimi dhe uzurpimi i pronës përbën një problem tjetër. Nga të dhënat e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, janë proceduar 14,000 raste, kryesisht nga ankesat e komunitetit serb. Këto raste përfshinin uzurpimin, shkatërrimin e pronave, kryesisht në fund të konfliktit në Kosovë në vitin 1999.³⁹ Duke pasur parasysh vëllimin e lartë të rasteve në sistemin gjyqësor të Kosovës, UNMIK ka suspenduar të gjitha rastet derisa të gjendet një mënyrë më e mirë për të procesuar të gjitha rastet.⁴⁰ Katër vjet më vonë në vitin 2008, UNMIK-u i këshilloi gjykatat e Kosovës që të vazhdonin me rastet. Megjithatë, ndërmjet viteve 2008 dhe

³⁶ Visoka, G. (2017), 'Vlerësimi i Ndikimit Potencial të Gjykatës Speciale të Kosovës'. Në dispozicion në: <https://www.impunitywatch.org/publications/vleresimi-i-ndikimit-potencial-te-gjykares-speciale-te-kosoves> [Qasur më: 14 tetor 2019].

³⁷ Strategjia për Komunitete dhe Kthim (2014), Në dispozicion në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf [Qasur më: 15 tetor 2019].

³⁸ Ministria për Komunitete dhe Kthim (2019), 'Ministria për Komunitete dhe Kthim- Misioni dhe Vizioni', Në dispozicion në: <http://mzp-rks.org/en/mission-and-vision.html> [Qasur më: 10 tetor 2019].

³⁹ Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. (2016). 'Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut: Historia dhe Trashëgimia e Kosovës, 2007-2016' fq.62, Në dispozicion në: <http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/default.aspx> [Qasur më: 13 tetor 2019].

⁴⁰ Po aty.

2010 kërkuesit e kompensimit ende nuk janë kontaktuar nga gjykatat, as data e mbajtjes së seancave nuk është caktuar. Edhe njëzet vjet pas luftës mijëra konteste pronësore vazhdojnë të jenë një problem për gjyqësorin e Kosovës. Ajo që e ka shkaktuar këtë problem është se dokumentet kadastrale të regjistruara në periudhën 1983-1999 janë hequr nga autoritetet serbe dhe si pasojë Kosovës i mungon një sasi e konsiderueshme e informacionit kadastral.⁴¹ Ka shumë raste ku ankuesit nuk i kanë pasur dokumentet pronësore në rregull si rezultat i mungesës së regjistrave kadastralë. Megjithatë, një marrëveshje është nënshkruar në mes Kosovës dhe Serbisë në Bruksel në vitin 2011 për kthimin e regjistrave kadastralë, dhe marrëveshja përfshin kthimin e rreth 4.6 milionë kopjeve të dokumenteve kadastrale.⁴² Sidoqoftë, problemi është më kompleks pasi pronat nuk janë regjistruar në mënyrën e duhur si pasojë e situatës së tensionuar dhe represive para konfliktit. Prandaj, kthimi i personave të zhvendosur përbën një problem të madh, së bashku me arritjen e kthimit të tyre të sigurt, integritetit si dhe pronave të dëmtuara, që mbulon Ministria në nivele të caktuara.

26. Me qëllim të lehtësimit të pajtimit dhe zbatimit të politikave qeveritare për integrimin e komuniteteve, u themeluan Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK). Formimi i këtyre zyrave përbën një zhvillim pozitiv në vetvete, por jo domosdoshmërisht ato zyra kanë përmbushur misionet e tyre. Në përgjithësi, këto zyra kanë dështuar të informojnë të kthyerit, t'i vlerësojnë nevojat e tyre, dhe të zbatojnë projekte në lidhje me nevojat e të kthyerve.⁴³ Mekanizmat institucionalë që kanë mandat për të mbështetur ZKKK nuk janë funksionalizuar në të gjitha komunat. Thënë këtë, riintegrimi i serbëve është ballafaquar me disa sfida të cilat në këtë situatë i shtojnë më shumë probleme procesit të pajtimit.

⁴¹ Balkan Insight (2019), 'Prona e humbur: Të dhënat e zhdukura të Kosovës zgjasin betejat ligjore të pasluftës'. Në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2019/04/03/lost-property-kosovos-missing-records-prolong-post-war-legal-battles/> [Qasur më: 12 tetor 2019].

⁴²Po aty.

⁴³ OSBE (2015), 'Raporti i Vlerësimit të të Drejtave të Komuniteteve, botimi i katër' fq.37, Në dispozicion në: <https://www.osce.org/kosovo/209956?download=true> [Qasur më: 14 tetor 2019].

27. Kuadri ligjor i Kosovës ka përfshirë instrumentet ligjore ndërkombëtare në sistemin e saj ligjor në mënyrë që të sigurojë një legjislacion gjithëpërfshirës për të gjitha komunitetet dhe promovimin e standardeve ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është etabluar si instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar ligjor për të matur llogaridhënien e institucioneve të Kosovës ndaj të drejtave të pakicave kombëtare.⁴⁴

28. Është e rëndësishme të theksohet këtu, se Republika e Kosovës garanton të drejtat e komuniteteve përmes disa ligjeve. Për shembull, ligji nr. 03 / L për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, ligji nr. 02 / L-37 për përdorimin e gjuhëve, si dhe me ligjet për arsimin siç janë: ligji nr. 04 / L-032 në arsimin parauniversitar; ligji nr. 03 / L-068 për arsimin në komunitet dhe Republikës së Kosovës. Këto ligje krijojnë një bazë të qëndrueshme ligjore për një integrim më të plotë të serbëve në sistemin ligjor në veçanti, dhe në shoqëri në përgjithësi.

29. Vizioni i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është për të kontribuar në ndërtimin e dialogut, besimit dhe pajtimit ndërmjet komuniteteve, si dhe sigurimin e politikave për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, të drejtave të njeriut dhe krijimin e kushteve për kthim të sigurt.⁴⁵ Thënë këtë, Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014-2018 është fokusuar në: riintegrimin e personave të zhvendosur, kthimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin ekonomik të komuniteteve.⁴⁶ Zbatimi i këtyre objektivave nga Ministria për Komunitete dhe Kthim ka dhënë rezultate të përziera. Ministria ka qenë një pikë kontakti për personat e zhvendosur dhe ka kontribuar në sigurimin e disa prej kushteve për këtë proces. Nga ana tjetër, janë evidentuar probleme me zbatimin e legjislacionit.

⁴⁴ OSBE (2015), 'Raporti i Vlerësimit të të Drejtave të Komuniteteve, botimi i katër' fq.38, Në dispozicion në: <https://www.osce.org/kosovo/209956?download=true> [Qasur më: 14 tetor 2019].

⁴⁵ Ministria për Komunitete dhe Kthim (2019), 'Ministria për Komunitete dhe Kthim - Misioni dhe Vizioni', Në dispozicion në: <http://mzp-rks.org/en/mission-and-vision.html> [Qasur më: 14 tetor 2019].

⁴⁶ Strategjia për Komunitete dhe Kthim (2014), Në dispozicion në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf [Qasur më: 14 tetor 2019].

Procesi i pajtimit përmes iniciativave të shoqërisë civile

- 30.** Organizatat e shoqërisë civile kanë bërë përpjekjet më të rëndësishme në procesin e pajtimit në Kosovë. Ndoshta, për shkak të mungesës së guximit politik ose vullnetit midis akterëve politikë, shoqëria civile është përfshirë dhe ka pasur një rol udhëheqës në procesin e pajtimit në Kosovë. Organizatat të tilla si Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut-KMDLNJ, Kryqi i Kuq i Kosovës, Shoqata e Familjeve të Personave të Zhdukur, Qendra për të Drejtën Humanitare, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës, Komisioni Rajonal për Fakte rreth të gjitha Viktimave të Krimeve të Luftërave dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë (KOMRA) dhe kështu me radhë, janë angazhuar aktivisht në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë dhe në Serbi.⁴⁷
- 31.** Ka pasur një ndikim të suksesshëm në dokumentimin e krimeve të luftës, siç janë vrasjet, personat e pagjetur, varrezat masive dhe kështu me radhë. Dokumentimi i këtyre çështjeve zakonisht ka ardhur nga dëshmitarët e GJPNJ-së dhe nga instancat e tjera gjyqësore.⁴⁸
- 32.** Një zhvillim i rëndësishëm ishte iniciativa KOMRA. Akronimi KOMRA qëndron për Komisionin Rajonal për Fakte rreth Viktimave të Luftërave në territorin e ish-Jugosllavisë prej 1 janar 1991 deri më 31 dhjetor 2001.⁴⁹ Koalicioni KOMRA u themelua me 28 tetor 2008 në Prishtinë, Kosovë në forumin e katërt për Drejtësi Tranzicionale në vendet post Jugosllave, me vendimin e 100 organizatave dhe bashkëpunëtorëve, që merren me të drejtat e njeriut, personat e pagjetur,

⁴⁷ UNDP (2017), 'Ballafaqimi me të Kaluarën dhe Pajtimi në Kosovë: Një përmbledhje e institucioneve dhe iniciativave' fq.14, Në dispozicion në:

https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/ALB_TJ%20Summary%20of%20Institutions%20and%20Initiatives.pdf [Qasur më: 14 tetor 2019].

⁴⁸ UNDP (2017), 'Ballafaqimi me të Kaluarën dhe Pajtimi në Kosovë: Një përmbledhje e institucioneve dhe iniciativave' Në dispozicion në:

https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/ALB_TJ%20Summary%20of%20Institutions%20and%20Initiatives.pdf [Qasur më: 14 tetor 2019].

⁴⁹ Iniciativa për KOMRA (2019) 'Çfarë është KOMRA'. Në dispozicion në: <http://recom.link/about-recom/what-is-recom/> [Qasur më: 12 tetor 2019].

organizatat rinore dhe kështu me radhë. Misioni i KOMRA-së është të përcaktojë faktet për të gjitha krimet e luftës, keqbërjet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, duke bërë kështu mbledhjen e të dhënave në çështje të veçanta, si dhe organizon dëgjime publike për dëshmitë e viktimave.⁵⁰ Koalicioni KOMRA ka bërë bashkë 2050 organizata jo-qeveritare nga të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë– me misionin e gjetjes së fakteve për atë që ka ndodhur në të kaluarën e afërt dhe përpilimin e rrëfimeve për krimet e luftës.

33. Grupi zyrtar i ekspertëve rajonal të KOMRA-s mbajti takimin e parë zyrtar në Zagreb në vitin 2013, i përbërë nga të dërguarit e presidencave të Kroacisë, Kosovës, Bosnjës dhe Hercegovinës, Serbisë dhe Malit të Zi si dhe avokuesit publikë të kësaj iniciative. Si përfaqësuesit e presidentëve ashtu edhe avokuesit publikë u pajtuan se statuti i propozuar i KOMRA-s siç është miratuar më 2011 përfaqëson një dokument bazik për ndërtimin e një konsensusi për diskutim dhe bashkëpunim zyrtar minimal.⁵¹ Megjithatë, koalicioni i KOMRA-s ende nuk e ka përmbushur misionin e tij të plotë për shkak të dështimit të Samitit të Ballkanit Perëndimor në Londër në vitin 2018 për të mbështetur ngritjen e komitetit rajonal të kërkimit të së vërtetës.

34. Megjithatë, KOMRA ka përparuar në zvogëlimin e dallimeve duke u bërë koalicion ndërqeveritar, në të cilin të gjitha shtetet kanë përfaqësuesit e tyre. Në këtë drejtim, Kosova gjithashtu kishte përfaqësuesin e saj nga zyra e presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga në vitet 2014-15.⁵² Sidoqoftë, KOMRA ka hasur në sfida dhe ka pasur keqkuptime konceptuale brenda vendeve të ish-Jugosllavisë. Një nga kritikrat më të mëdha që bie mbi KOMRA-n në kontekstin e pajtimit ishte iniciativa për t'i vënë të gjitha viktimat në pozitë të barabartë, për të siguruar një forum

⁵⁰Po aty.

⁵¹ Iniciativa për KOMRA (2019) 'Çfarë është KOMRA'. Në dispozicion në: <http://recom.link/about-recom/what-is-recom/> [Qasur më: 12 tetor 2019].

⁵² UNDP (2017), 'Ballafaqimi me të Kaluarën dhe Pajtimi në Kosovë: Një përmbledhje e institucioneve dhe iniciativave'. Në dispozicion në: https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/ALB_TJ%20Summary%20of%20Institutions%20and%20Initiatives.pdf [Qasur më: 14 tetor 2019].

rajonat për të gjitha entitetet.⁵³ Pavarësisht kësaj, koalicioni i KOMRA-s me bashkëpunëtorët e tij dhe organizatat joqeveritare ka ofruar disa dokumente për humbjet njerëzore, kampet dhe objektet tjera të paraburgimit, si dhe publikime për Drejtësinë Tranzicionale dhe Pajtimin.⁵⁴

35. Sidoqoftë, iniciativa u përball me mungesën e mbështetjes nga qeveria e Kosovës dhe nga qeveritë e tjera rajonale. Një problem tjetër që e rrezikoi iniciativën ishte mohimi politik i krimeve dhe keqbërjeve. Në këtë mënyrë, Serbia përqafoi viktimizimin dhe justifikoi krimet e saj si akte mbrojtjeje. Pra, mungesa e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë të procesit të pajtimit e ka stagnuar nismën e KOMRA-s për pajtimin ndër-rajonat.⁵⁵

Ekipi Përgatitor i Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë

36. Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka filluar formimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit për t'u marrë me narrativat e konfliktit duke marrë në konsideratë të gjitha perspektivat nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, veçanërisht shqiptarët dhe serbët. Me qëllim të funksionalizimit të Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit, një ekip përgatitor u emërua nga Presidenti i Kosovës, i cili përbëhet nga nëntë anëtarë. Shumica e anëtarëve janë nga shoqëria civile, gjithashtu përfaqësues nga zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe ekspertët ndërkombëtarë janë pjesë e ekipit.⁵⁶

⁵³Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (2017), 'Zbërthimi i pajtimit në Kosovë' fq.18. Në dispozicion në: <https://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2017/06/Zb%C3%ABrthimi-i-konceptit-%C3%AB-pajtimit-n%C3%AB-kontekstin-e-Kosov%C3%ABs-Deconstructing-Reconciliation-Qershor-2017.pdf> [Qasur më: 13 tetor 2019].

⁵⁴ KOMRA (2019), 'Çfarë është KOMRA,' Në dispozicion në: <http://recom.link/about-recom/what-is-recom/> [Qasur më: 14 tetor 2019].

⁵⁵ Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (2017), 'Zbërthimi i pajtimit në Kosovë' fq.19. Në dispozicion në: <https://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2017/06/Zb%C3%ABrthimi-i-konceptit-%C3%AB-pajtimit-n%C3%AB-kontekstin-e-Kosov%C3%ABs-Deconstructing-Reconciliation-Qershor-2017.pdf> [Qasur më: 14 tetor 2019].

⁵⁶ Presidenti i Republikës së Kosovës (2017), 'Presidenti themeloi Ekipin Përgatitor për Komisionin e të Vërtetës dhe Pajtimit'. Në dispozicion në: <https://www.president-ks.gov.net/en/news/the-president-established-the-preparatory-team-for-the-truth-and-reconciliation-commission> [Qasur më: 14 tetor 2019].

37. KVP do të shërbejë si një forum që do të ndihmonte në përshkrimin e krimeve, në të gjitha aspektet: aspektin kriminal; social dhe gjeografik gjithashtu. Qëllimi i KVP-së është të dokumentojë dhe vërtetojë faktet nga konflikti i dhunshëm, dhe të kontribuoj në transformimin shoqëror për të parandaluar përsëritjen e abuzimeve dhe shkeljeve të pësura dhe të rivendos dinjitetin e viktimave nga të gjitha komunitetet. Gjithashtu, KVP synon të mbledh të gjitha narrativat që secili komunitet ka ndërtuar për veten dhe palën tjetër, e që shumë shpesh kundërshtojnë njëra-tjetrën.⁵⁷

38. Në veçanti, roli i KVP-së është të dokumentojë narracionet e viktimave dhe autorëve të krimit. Megjithatë, detyrat e KVP-së janë shumë komplekse dhe nëse nuk trajtohen si duhet mund t'i përkeqësojnë në vend se t'i përmirësojnë marrëdhëniet në mes komuniteteve në Kosovë. Por, pajtimi nuk duhet të reduktohet vetëm në Komisionin e së Vërtetës dhe Pajtimin, por Kosova, si dhe Serbia duhet të forcojnë institucionet që respektojnë të drejtat e njeriut dhe që janë të denjë për t'u besuar. Ky komision nuk do të zëvendësonte drejtësinë, por do të kontribuonte në dokumentimin dhe përcaktimin e fakteve të shkeljeve gjatë konfliktit të armatosur, rivendosjen e dinjitetit të të gjitha komuniteteve.⁵⁸

39. Për pajtimin mes shoqërive dhe shteteve vetëm drejtësia penale nuk mund të ndihmojë në këtë drejtim. Prandaj, fokusi kryesor i KVP-së është njohja e statusit së viktimës dhe mënyrës se si viktimat e kanë përjetuar konfliktin, por gjithashtu të adresojë perceptimin dhe përjetimin e konfliktit nga ana e tyre. Parimet dhe vlerat e KVP-së janë përshtatur si më poshtë:

- *Do të respektojë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut;*

⁵⁷ Presidenti i Republikës së Kosovës (2018), 'Deklarata e ekipit përgatitor për themelimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimin'. Në dispozicion në: https://www.president-ks.gov.net/repository/docs/2019_01_17_143401_DECLARATION17119.pdf [Qasur më 15 tetor 2019].

⁵⁸ Qendra për Hulumtim Dokumentim dhe Publikim (2018), 'Zbërthimi i pajtimin në Kosovë'. Në dispozicion në: <https://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2017/06/Zb%C3%ABrthimi-i-konceptit-t%C3%AB-pajtimin-n%C3%AB-kontekstin-e-Kosov%C3%ABs-Deconstructing-Reconciliation-Qershor-2017.pdf> [Qasur më 14 tetor 2019].

- *Ka fokus të veçantë tek viktimat civile: i mbron, njuh dhe i fuqizon ato;*
- *Është i përbërë nga njerëz me integritet të lartë, të përzgjedhur nga një proces transparent i ndjekur nga standardet më të larta të etikës profesionale;*
- *Është i pavarur dhe vendimet e tij nuk ndikohen politikisht;*
- *Do të jetë përgjegjës, i përgjegjshëm, i qasshëm dhe i hapur për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe akterët e interesuar;*
- *Parandalon racizmin, seksizmin dhe diskriminimin gjinor gjatë procesit, në punën e tij dhe në rezultatet e procesit;*
- *Do të ndjekë ekzaminimin rigoroz dhe metodik të fakteve dhe ngjarjeve të së kaluarës, në përputhje me korrektësinë procedurale.⁵⁹*

40. Rrjedhimisht, KVP do të kryejë hulumtime, konsultime publike, takime me palët kyçe politike dhe qytetarë në Kosovë, në mënyrë që të hartojë raporte dhe dokumente që do ta bënin KVP-në funksionale dhe në gjendje për të përmbushur qëllimet e saj. ⁶⁰

41. Megjithatë, kjo iniciativë është pranuar me qëndrime të ndryshme. Ndërsa ekziston një dyshim dhe mosbesim i madh në qëllimet dhe suksesin e mundshëm të komisionit, sidoqoftë, për shumë të tjerë KVP-ja hap horizonte të reja për pajtim. KVP-ja ka fituar përkrahje edhe nga misionet ndërkombëtare në Kosovë. Në vitin 2019, KVP ka mbajtur nëntë takime publike konsultative me grupe të ndryshme siç janë: historianët, veteranët shqiptarë të luftës, komunitetin Serb, anëtarët e familjeve të personave të pagjetur, ekspertët ligjorë dhe kështu me radhë. ⁶¹

⁵⁹ Presidenti i Republikës së Kosovës (2018), 'Deklarata e ekipit përgatitor për themelimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit'. Në dispozicion në: https://www.president-ksgov.net/repository/docs/2019_01_17_143401_DECLARATION17119.pdf [Qasur më: 15 tetor 2019].

⁶⁰Po aty.

⁶¹ Presidenti i Republikës së Kosovës (2018), 'Ekipi përgatitor për themelimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit'. Në dispozicion në: <https://www.president-ksgov.net/en/preparatory-team-for-the-establishment-of-the-truth-and-reconciliation-commission> [Qasur më: 14 tetor 2019].

42. Iniciativat kontradiktore dhe qasjet nga aktorë të ndryshëm shtetëror në lidhje me pajtimin, e kanë dëmtuar procesin në vetëvete dhe shpesh herë kanë gjeneruar dyshime.⁶² Prandaj, KVP nuk ka një detyrë të lehtë, dhe për të arritur qëllimet pritet të përballlet me shumë sfida, pasi që misioni i tij tenton të pajtojë komunitetet të cilat ende janë të mbërthyer në rrëfimet e tyre të konfliktit. Megjithatë, ekzistojnë shembuj të suksesshëm dhe dështime të KVP-ve në të gjithë botën. Një shembull i suksesshëm që mund të merret parasysh është KVP i Sierra Leone-s.

Institucionet ligjore dhe mekanizmat e Serbisë që merren me krimet e luftës në Kosovë

43. Sistemi politik dhe gjyqësor i Serbisë pas konflikteve në ish-Jugosllavi ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme. Në vitin 2003, Serbia miratoi Ligjin për Krimet e Luftës dhe krijoi struktura institucionale brenda Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatave për t'u marrë me krimet e luftës në ish-Jugosllavi. Për më tepër, ky ligj i jep juridiksion Serbisë mbi krimet e kryera në territorin e të gjithë ish Jugosllavisë, pavarësisht nga nacionaliteti i të dyshuarit ose viktimave dhe pavarësisht pranisë së të dyshuarit në territorin e Serbisë".⁶³ Përveç kësaj, Ligji për Krimet e Luftës ka themeluar institucione të tilla si: Prokuroria e Krimeve të Luftës (PKL), Departamenti i Krimeve të Luftës (DKL) Shërbimi për Hetimin e Krimeve të Luftës (SHHKL) dhe të gjitha këto institucione janë të bazuara në Beograd, Serbi.⁶⁴

44. PKL dhe DKL kanë juridiksion mbi krimet kundër njerëzimit, genocidit apo agresionit, megjithatë, asnjë i pandehur nuk është akuzuar për ato krime.⁶⁵ Përderisa GJPNJ paditi zyrtarë të nivelit të lartë, institucionet e krimeve të luftës në

⁶² Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (2018), 'Zbërthimi i pajtimit në Kosovë'. Në dispozicion në: <https://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2017/06/Zb%C3%ABrthimi-i-konceptit-t%C3%AB-pajtimit-n%C3%AB-kontekstin-e-Kosov%C3%ABs-Deconstructing-Reconciliation-Qershor-2017.pdf> [Qasur më: 13 tetor 2019].

⁶³ OSBE (2015), 'Ndjekja e krimeve të luftës në Serbi (2003-2014)' fq.29. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/serbia/194461?download=true> [Qasur më: 12 tetor 2019].

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ OSBE (2015), 'Ndjekja e krimeve të luftës në Serbi(2003-2014)' fq.23. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/serbia/194461?download=true> [Qasur më: 12 tetor 2019].

Serbi vazhduan me ndjekje penale të nivelit të mesëm. Aktakuzat më të shumta të rangut të mesëm kanë ndodhur gjatë viteve të para të punës së këtyre institucioneve, ndërsa që nga viti 2009 të gjithë të pandehurit ishin të rangut të ulët.⁶⁶

45. Për më tepër, rastet e ndjekura në Serbi kanë mbuluar krimet e kryera kundër 1.100 viktimave që i përkasin të gjitha kombësive që ishin përfshirë në konfliktet e ish-Jugosllavisë (shqiptarët, boshnjakët, kroatët, romët dhe serbët). Shumica e rasteve përfshijnë krime kundër viktimave të përkatësisë etnike kroate që përbëjnë 35% të rasteve, pasuar me raste për krime kundër etnisë boshnjake, që përbëjnë 28% të rasteve. Rastet për krime kundër shqiptarëve të Kosovës përbëjnë 14%, pasuar me raste kundër viktimave rome, të cilat përbëjnë 7%. Rastet për krime kundër nacionalitetit serb janë 16%.⁶⁷

46. Përveç kësaj, nga fillimi i veprimtarisë së saj në nëntor 2003 deri në fund të vitit 2014, Zyra e Prokurorisë së Krimeve të Luftës (ZPKL) ka akuzuar 162 të pandehur për krime lufte kundër civilëve dhe të burgosurve të luftës. Pothuajse tre të katërtat e të akuzuarve kanë qenë anëtarë të ushtrisë (duke përfshirë "forcat territoriale"), ndërsa forcat policore dhe paramilitare përbëjnë gati të gjitha ato raste të mbetura.⁶⁸ Shumica (86%) e palës mbrojtëse janë anëtarë të mëhershëm të forcave serbe. Shqiptarët ishin të akuzuar në një rast të vetëm, gjë që rezultoi në lirimin e të gjithë 17 të pandehurve. Vetëm tre të pandehur i përkisnin forcave boshnjake ose kroate.

47. Pas ndryshimeve të thella politike në fillim të viteve 2000, Serbia filloi ta trajtojë trashëgiminë e saj të konflikteve të cilat kishin përkrahur territorin e ish-Jugosllavisë gjatë viteve të 90-ta. Që nga viti 2003 me themelimin e institucioneve

⁶⁶ OSBE (2015), 'Ndjekja e krimeve të luftës në Serbi(2003-2014)' fq.45. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/serbia/194461?download=true> [Qasur më: 14 tetor 2019].

⁶⁷ OSBE (2015), 'Ndjekja e krimeve të luftës në Serbi(2003-2014)' fq.46. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/serbia/194461?download=true> [Qasur më: 12 tetor 2019].

⁶⁸ OSBE (2015), 'Ndjekja e krimeve të luftës në Serbi (2003-2014)'. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/serbia/194461?download=true> [Qasur më: 12 tetor 2019].

të specializuara përgjegjëse për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, Serbia nuk ka bërë përmirësime në vendosjen e përgjegjësisë për mizoritë e së kaluarës. Në përgjithësi, këto institucione kanë qenë shumë shpesh cak i kritikave nga njëvarg i palëve të interesit dhe me ndikim në vendimmarje në Serbi. "Organizatave të drejtave të njeriut kanë theksuar çështje të tilla si numri i ulët i rasteve të procesuara, mbështetja e pamjaftueshme e dhënë palëve të dëmtuara dhe praktika me dënime të buta".⁶⁹

48. Prokurori i krimeve të luftës emërohet nga Parlamenti në mesin kandidatëve të tjerë që emërohen nga qeveria. Përveç kësaj, gjykatësit që merren me krimet e luftës emërohen nga parlamenti. Prandaj, sistemi gjyqësor i Serbisë dhe kuadri i saj ligjor lënë hapësirë për ndikim politik. Përveç kësaj, ka mbështetje të ulët publike në mesin e popullatës serbe për ndjekjen e krimeve të luftës.⁷⁰

49. Me qëllim të përmirësimit të ndjekjes penale të krimeve të luftës, Republika e Serbisë miratoi Strategjinë Kombëtare për Prokurorinë e Krimeve të Luftës 2016-2020, e cila vlerësoi një varg aktivitete për të ndihmuar në përmirësimin e ndjekjes penale të krimeve të luftës si objektiv i përbashkët. Përveç kësaj, 'përcaktimi i përgjegjësisë penale individuale për krimet e luftës të kryera gjatë viteve 1990-ta është një nga kushtet formale që Serbia duhet të përmbushë për të hyrë në BE'.⁷¹ Ajo që mund të shihet nga raporti i FDH-së është se zbatimi i Strategjisë Kombëtare është vonuar shumë, gjykimet për krimet e luftës vazhdojnë pafundësisht dhe numri i personave të pagjetur po zvogëlohet me një ritëm më të ngadalshëm.⁷²

50. Mungesa e rezultateve të qarta kur bëhet fjalë për aktakuzat e krimeve të luftës ka rrezikuar normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve dhe shoqërive. "Në

⁶⁹Po aty.

⁷⁰Po aty.

⁷¹Fondi për të Drejtën Humanitare. (2016). 'Drejtësia Tranzicionale në Serbi në periudhën prej 2013 – 2015.' Në dispozicion në: http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2016/06/izvestaj_o_TP_2013-2015_eng.pdf[Qasur më: 15 tetor 2019].

⁷²Po aty.

rastet e krimeve të luftës të kryera në Kosovë, ZPKL shpeshherë hedh aktakuza në bazë të hetimeve të pjesshme, siç ndodhi në Suharekë dhe Qyshk.⁷³ Gjykata e Apelit në Beograd ka vazhduar të miratoj dënimet e ulëta me burg, kjo dëmton ndjeshëm iniciativat për rivendosjen e paqes ndërmjet komuniteteve, pasi që autorët e krimit mbetën të lirë.

51. Për t'u pajtuar të dy shtetet duhet të sigurojnë informata adekuate për personat e pagjetur, viktimat e luftës dhe keqbërjet e tjera të kryera. Nga shumë institucione ndërkombëtare konsiderohet se institucionet serbe kanë informacion për shumë vendndodhje të personave të pagjetur nga Kosova.⁷⁴ Në këtë fushë, qeveria serbe dhe institucionet e tjera duhet të japin informacion rreth vendndodhjes së personave të pagjetur. Serbia ka informacion lidhur me zhdukjen e detyruar gjatë konfliktit të armatosur në vitet 1998-1999 dhe pasojat e tij. Edhe pse një numër i tyre janë gjetur, 1,647 persona ende janë të pagjetur nga Kosova.⁷⁵

52. Urrejtja dhe mosbesimi ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve janë ende të pranishme. Thënë këtë, tkurrja e armiqësive dhe krijimi i një ambienti të përshtatshëm për marrëdhëniet normale duhet të jetë i domosdoshëm për të dy shtetet. Ky mjedis mund të krijohet duke u marrë me të kaluarën si një kusht themelor për të ecur përpara. Në lidhje me këtë, vendosja e drejtësisë është një parakusht për pajtimin, pasi që të dy komunitetet kërkojnë njohjen e viktimizimit të tyre dhe krimet e kryera. Pajtimi mund të zhvillohet në shumë nivele të tilla si: niveli individual, niveli i komunitetit, por ende më i rëndësishmi mbetet niveli politik. Kjo për shkak

⁷³Fondi për të Drejtën Humanitare (2012), 'Drejtësia Tranzicionale në vendet post- Jugosllave; Raporti 2010-2011', fq.4. Në dispozicion në: <http://www.hlc-rdc.org/?p=22665&lang=de> [Qasur më: 14 tetor 2019].

⁷⁴Komisioneri për të Drejtat e Njeriut (2017), 'Memorandumi pas misionit të Komisionerit në Kosovë*'. Në dispozicion në: <https://rm.coe.int/memorandum-following-the-commissioner-s-mission-to-kosovo-from-5-to-9-/16807ba832>[Qasur më: 14 tetor 2019].

⁷⁵ ICRC (2018), 'Njëzet vite mbrapa, 1,647 persona akoma të pagjetur në Kosovë'. Në dispozicion në: <https://www.icrc.org/en/document/twenty-years-1647-people-still-missing-kosovo> [Qasur më: 14 tetor 2019].

se niveli politik përcakton kushtet për individët dhe komunitetet për të kërkuar një proces të tillë si pajtimi.⁷⁶

53. Megjithatë, pajtimi mes Kosovës dhe Serbisë mbetet sfidues pasi të dy vendet nuk kanë marrëdhënie zyrtare dypalëshe dhe mbajnë pozitat e tyre armiqësore. Megjithëse kjo paraqet një problem serioz, nuk e bllokoi procesin e pajtimit në thelb. Ajo që e ka zgjatur procesin është mosgatishmëria e elitave politike dhe institucioneve për t'u marrë me të kaluarën dhe për të marrë masa të domosdoshme për njohjen e keqbërjeve dhe për të proceduar krimet e luftës. Prandaj, çështja e ballafaqimit me të kaluarën do të jetë një sfidë shumë e madhe që duhet të adresohet në dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit të lehtësuar nga BE-ja.

54. Serbia, si dhe Kosova duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për fatin e personave të pagjetur dhe krimet e luftës në përgjithësi. Në të kundërtën, komunitetet nuk mund të krijojnë besim dhe mirëkuptim për të vazhduar procesin e pajtimit. Prandaj, kryeministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Serbinë dhe Kosovën, kanë nënshkruar një deklaratë të përbashkët në Samitin e Ballkanit Perëndimor në kuadrin e Procesit të Berlinit në vitin 2018, i cili thekson rëndësinë e gjetjes së personave të pagjetur dhe vendndodhjen e tyre dhe sjelljen e autorëve të krimit përpara drejtësisë.⁷⁷

55. Disa nga pikat e deklaratës së përbashkët në lidhje me personat e pagjetur dhe krimet e luftës përfshijnë deklaratat vijuese: *të siguroj hetime të paanshme dhe efektive për rastet e personave të pagjetur në përputhje me standardet*

⁷⁶ Qendra për Hulumtim Dokumentim dhe Publikim (2018), 'Zbërthimi i pajtimit në Kosovë' fq.8 . Në dispozicion në: <https://crdp-ks.org/wp-content/uploads/2017/06/Zb%C3%ABrthimi-i-konceptit-t%C3%AB-pajtimit-n%C3%AB-kontekstin-e-Kosov%C3%ABs-Deconstructing-Reconciliation-Qershor-2017.pdf>[Qasur më: 14 tetor 2019].

⁷⁷ Samiti i Ballkanit Perëndimor Londër (2018), 'Deklaratat e përbashkëta për bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, krimet e luftës dhe personat e zhdukur në kuadrin e Procesit të Berlinit'. Në dispozicion në: https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/724294/180710_WBS_Joint_Declarations.pdf[Qasur më: 14 tetor 2019].

ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të zgjidh sa më shumë raste të personave të pagjetur gjatë pesë viteve të ardhshme; të angazhoj në mënyrë aktive të gjitha institucionet vendore që janë përgjegjëse në gjetjen dhe/ose identifikimin e varrezave, duke përfshirë angazhimin për të hulumtuar në mënyrë adekuate kërkimin e arkivave për informacionin përkatës, dhe transmetimin e këtij informacioni tek institucioni qendror përkatës; të sigurojë institucionin qendror kompetent nga secili prej pjesëmarrësve të Procesit të Berlinit të cilët janë përgjegjës për kërkimin dhe/ose identifikimin e personave të pagjetur me burime adekuate njerëzore dhe buxhetore për të përmbushur mandatin e tyre.⁷⁸

56. Deklarata e përbashkët për krimet e luftës në kuadër të Procesit të Berlinit thekson rëndësinë e; *Njohjes së rritjes së urgjencës për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për të kapërcyer trashëgiminë e së kaluarës, duke përfshirë drejtësinë për të gjitha viktimat e mizorive të së kaluarës; me vendosmëri për të promovuar sundimin e ligjit, duke përfshirë si një parim qendror të procesit të pranimit në BE; duke riafirmuar rëndësinë e pavarësisë së gjyqësorit.⁷⁹*

57. Siç mund të vërehet, aspektet themelore për të ecur përpara janë krimet e luftës, të cilat kërkojnë masa të qëndrueshme nga qeveritë. Të dy deklaratat e përbashkëta përbëjnë zhvillime pozitive, megjithatë deklaratat nuk janë ligjërish të detyrueshme, gjë që në këtë rast shpreh më shumë vullnetin e qeverive për të përmbushur parimet e shpallura.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe Pajtimi

58. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka filluar që nga viti 2011. Dialogu filloi me qëllim që të dyja vendet të normalizojnë marrëdhëniet

⁷⁸Po aty.

⁷⁹ Samiti i Ballkanit Perëndimor Londër (2018), 'Deklaratat e përbashkëta për bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, krimet e luftës dhe personat e zhdukur në kuadrin e Procesit të Berlinit'. Në dispozicion në: https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/724294/180710_WBS_Joint_Declarations.pdf[Qasur më 14 tetor 2019].

dhe të integrohen në BE. Në mënyrë që të bëjnë progres në procesin e integritimit në BE, Kosova dhe Serbia duhet të krijojnë marrëdhënie të mira fqinjësore ndërmjet vete dhe me të gjitha vendet e rajonit.

59. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka rezultuar në marrëveshje të shumta të cilat në thelb janë menduar që të krijojnë një mjedis të qëndrueshëm për bashkëpunim, normalizim dhe pajtim.⁸⁰ Procesi i dialogut është mbështetur nga shumica e partive politike në të dy shtetet, megjithatë, narracionet politike në shumë raste kanë ndërprerë dialogun duke krijuar divergjenca në të dy shtetet.

60. Disa nga marrëveshjet e kanë rritur bashkëpunimin, ndërkohë që disa të tjera i kanë larguar edhe më tej palët nga qëllimi fillestar – që është normalizimi i marrëdhënieve. Marrëveshjet teknike u pranuan më lehtë nga të dyja palët, siç janë: librat kadastralë, librat regjistruar, vulat doganore, diplomat universitare, liria e lëvizjes, prezantimi rajonal, vizitat zyrtare, menaxhimi i integruar i kufirit të pikave administrative të kalimit.⁸¹ Sidoqoftë, sipas institucioneve të Kosovës, Serbia ka bllokuar pesë marrëveshje teknike. Këto marrëveshje përfshijnë ato për energji, kthimin e librave kadastralë, njohjen e diplomave universitare, lirinë e lëvizjes në urën e lumit Ibër në Mitrovicë dhe lejimin e përdorimit të objekteve me qera në Mitrovicën Veriore. Ndërkohë, pala serbe këmbëngul në formimin më të shpejtë të Asociacionit të komunave me shumicë serbe.⁸²

61. Për më tepër, dialogu është përballur me shumë kriza veçanërisht në lidhje me marrëveshjet politike të cilat në përgjithësi kanë pasur qëndrime të ndryshme nga të dyja palët. Marrëveshja ‘famshme’ e formimit të Asociacionit/Bashkësisë së

⁸⁰ European Union External Action (2016), ‘Dialogu ndërmjet Begoradit dhe Prishtinës’. Në dispozicion në: https://eeas.europa.eu/diplomatic-network/eu-facilitated-dialogue-belgrade-pristina-relations/349/dialogue-between-belgrade-and-pristina_en [Qasur më: 13 tetor 2019].

⁸¹ Qeveria e Republikës së Serbisë (2019), ‘Procesi i negociatave me Prishtinën - Zyra për Çështje të Koordinimit në procesin e negociatave me Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Prishtinë’. Në dispozicion në: <http://www.kord-kim.gov.rs/eng/pregovaracki-proces.php> [Qasur më: 15 tetor 2019].

⁸² Radio Evropa e Lirë (2018), ‘Dialogu drejt Bllokadës’. Në dispozicion në: <https://www.evropalire.org/a/dialogu-drejt-bllokades-/29288957.html> [Qasur më 13 tetor 2019].

komunave me shumicë serbe në Kosovë ka krijuar kritika dhe pengesa të shumta në zbatim, dhe më vonë zbatimi i marrëveshjes si e tillë është komplikuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese në Kosovë.⁸³

62. Edhe pse dialogu është menduar si një platformë e padiskutueshme për normalizimin e marrëdhënieve dhe pajtimin, ky i fundit nuk shihet si i zbatueshëm. Serbia ende nuk ka ofruar të gjithë informacionin lidhur me personat e pagjetur, nuk ka arritur asnjë marrëveshje për dëmshpërblimet e luftës dhe nuk është bërë asnjë kërkim falje për masakrat dhe mizoritë që ka bërë në Kosovë. Prandaj, Kosova duhet të shfrytëzoj pozitën e saj në dialog duke synuar një kërkim falje nga Serbia, kështu që kërkim falja do të shërbente si një domosdoshmëri për pajtimin e komuniteteve.

63. Serbia nuk ka shfaqur ndonjë shenjë të kërkim faljes, përkundrazi jo në pak raste zyrtarët serbë kanë mohuar masakrat që kanë ndodhur në Kosovë. Në një rast të veçantë ministri i jashtëm serb, Ivica Dačić, e mohoi masakrën në fshatin e Reçakut, në Kosovë duke deklaruar se: "Reçaku nuk e ka parë të vërtetën e shpallur", "Aty nuk ka pasur gra dhe fëmijë, nuk ka pasur masakër."⁸⁴ Këto deklarata nga akterët politikë të cilët janë pjesë e dialogut politik për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë kontribuojnë në mënyrë negative tek popullsia për të arritur pajtimin ndërmjet komuniteteve.

64. Statusi i viktimave duhet të jetë i njëjtë pavarësisht nga kombësia. Kosova duhet të ripohoj përsëri gatishmërinë e saj për t'u marrë me krimet e luftës dhe për t'i mbajtur përgjegjës për veprimet e tyre ata që kryen krime. Sidoqoftë, Serbia duhet të përmbushë premtimet e saj kur bëhet fjalë për ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe mbajtjen e përgjegjësisë për ata që janë përgjegjës për veprimet, pasi ky

⁸³Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (2015), 'Aktgjykim në Rastin nr.K0130/15'. Në dispozicion në: http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf [Qasur më: 15 tetor 2019].

⁸⁴ B92 (2017), "Nuk kishte gra dhe fëmijë, nuk kishte masakër". Në dispozicion në: https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=05&dd=17&nav_id=101290 [Qasur më: 11 tetor 2019].

ishite një nga kushtet me të cilat ka ra dakord Beogradi. Deri më tani, dialogu politik ka treguar dallimet mes palëve dhe çdo marrëveshje e mundshme duhet të marrë parasysh të gjithë procesin në vend.

65. Nuk mund të ketë dyshime se e ardhmja e pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë varet nga rezultatet e dialogut të Brukselit. Çdo marrëveshje e mundshme ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet që gjithashtu të përfshijë një marrëveshje për njohjen e viktimave, dëmshpërblimet, kompensimin dhe kërkim faljen.

Përfundime

66. Procesi i pajtimit është mjaft sfidues. Nga 1999-2018, kryesisht aktorë ndërkombëtarë kanë qenë përgjegjës për trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë. Deri më tani, ka shumë pak, nëse jo aspak, përparim drejt trajtimit të krimeve të luftës.

67. Grindjet dhe ankesat politike kanë qenë një faktor jashtëzakonisht pengues në trajtimin e krimeve të luftës. Elitat politike në të dy vendet kanë promovuar diskursin nacionalist i cili ka krijuar më shumë mangësi sesa kompromis në këtë rrugë të vështirë drejt pajtimit. E ardhmja e pajtimit mbështetet edhe në përpjekjet dhe politikat e BE-së, përveç në të dyja shtetet. Dialogu politik në Bruksel është paraqitur si burimi kryesor për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Megjithatë, nuk është arritur asnjë marrëveshje substanciale që do t'i jepte fund konfliktit 'të hapur' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërish obligative mund të shihet si një opsion i mundshëm për pajtim, me të dyja palët të cilat pajtohen për njohjen e keqbërjeve nga e kaluara, dhe vendosjen e bazës së pajtimit të ndërsjellë bazuar në parimet dhe vlerat Evropiane.

Rekomandime

- 68.** Si Kosova ashtu edhe Serbia duhet të bashkëpunojnë në trajtimin e krimeve të luftës. Adresimi i trashëgimisë së luftës duhet të jetë një temë kryesore në dialogun e Brukselit.
- 69.** Kosova duhet ta kushtëzojë Serbinë të zotohet se do të bëjë një kërkim falje për krimet e kryera gjatë vitit 1999, si një hap drejt normalizimit të marrëdhënieve.
- 70.** Kosova duhet ta kushtëzojë Serbinë të implementojë politika për dhënien e reparacioneve për krimet e luftës, siç është kompensimi i viktimave me mjete materiale. Kjo duhet të trajtohet në dialogun e Brukselit.
- 71.** Kosova duhet t'i kërkojë Serbisë të formojë një Komision për të Vërtetën dhe Pajtimin për krimet e luftës në Kosovë. Kosova duhet të tregojë gatishmërinë për të formuar KVP-në me kusht që Serbia të iniciojë një proces paralel.
- 72.** Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtitimit duhet të mbledhë narrativa të konfliktit duke marrë parasysh të gjitha historitë dhe perspektivat nga të gjitha anët.
- 73.** Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtitimit duhet të angazhojë qytetarë të të gjitha komuniteteve në procesin e së vërtetës që do të ndihmonte në dallimin e viktimës dhe kryerësit të krimit. Për më tepër, KVP duhet të shërbejë si një pikë lidhëse për familjet e personave të pagjetur në Kosovë dhe në Serbi në organizimin e memorializimit të personave të pagjetur.
- 74.** Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtitimit në bashkëpunim me institucionet ligjore në Kosovë duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për trajtimin e kryesve të veprave penale. KVP-ja dhe institucionet e Kosovës duhet të vendosin se cilat masa do të ndërmerren për autorët në rast se autorët vendosin të ndajnë historitë e tyre.

- 75.** Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit duhet të marrë parasysh sukseset dhe dështimet e KVP-ve të tjera në mbarë botën. KVP-ja duhet të veprojë në përputhje me rrethanat sociale, politike dhe historike të Kosovës dhe rajonit, duke zbatuar praktikatat më të mira nga jashtë.
- 76.** Kosova dhe Serbia duhet të mbështesin viktimat me ndihmë juridike dhe financiare për të vazhduar me rastet e tyre individuale në gjykata dhe t'i mbështesin ato gjatë gjithë procesit.
- 77.** Kosova duhet të shtojë përpjekjet për të dokumentuar trashëgiminë e konfliktit si një masë e nevojshme për t'u marrë me të kaluarën.
- 78.** Kosova duhet të krijojë një bazë të dhënash për krimet e luftës dhe dëmet e tjera duke përfshirë të gjitha rastet nga të gjitha kombësitë e përfshira në konflikt dhe të bashkëpunoj me organizatat e shoqërisë civile që trajtojnë këto çështje.
- 79.** Kosova dhe Serbia, me BE-në si autoritet mentorues dhe monitorues, duhet të krijojnë ekipe të përbashkëta të ekspertëve të pavarur për t'u marrë me trashëgimitë e konfliktit të të dy vendeve.
- 80.** Kosova duhet të krijojë politika dhe mekanizma të rinj që merren me pajtimin duke marrë parasysh të gjitha perspektivat e të gjithë akterëve, dhe në këtë drejtim të përmirësojë perceptimin e publikut ndaj këtij procesi.
- 81.** BE-ja duhet të shtojë përpjekjet e saj për të bindur Serbinë dhe Kosovën për t'i dhënë fund mosmarrëveshjeve dhe për të siguruar një bazë të fortë për procesin e pajtimit ndërmjet dy vendeve.
- 82.** Mekanizmat ndërkombëtarë, në veçanti BE-ja, duhet të angazhohen vazhdimisht në dialogun politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe të mbikëqyrin marrëveshjet në lidhje me normalizimin e marrëdhënieve dhe pajtimin.

